

*Prindërit duhet të kenë parasysh, se për fëmijët, gjatë fëmijërisë së hershme, vëmendja dhe përqëndrimi mbi një veprimtari të caktuar janë të ndryshme tek fëmijë të ndyshëm, si pjesë unike individuale e zhvillimit të tyre.*



*Duke i shpërblyer fëmijët edhe kur gabojnë, i ndihmoni ata të mos dekurajohen, sepse po mësojnë se përpjekja vlerësohet.*



**Qendra Ekonomike e  
Zhvillimit dhe Edukimit të  
Fëmijëve.**

**Këshilla për  
reduktimin e  
hiperaktivitetit dhe  
mungesës së  
vëmendjes tek fëmijët  
(0-3) vjeç**

**Adresa: Rruga e Barrikadave.  
Nr.tel. 042222991**



## Këshilla për prindërit për menaxhimin e hiperaktivitetit dhe mungesës së vëmendjes tek fëmijët 0-3 vjeç

Kur mund të themi se çrregullimi i vëmendjes dhe shpërqëndrimi i fëmijës janë karakteristikë jonormale e zhvillimit?

- Atëherë kur këto shqetësime pengojnë realizimin e aktiviteteve të thjeshta të rutinës ditore të fëmijës. Ndryshe mund ta përcaktojmë si pamundësi për të realizuar një aktivitet, sado i thjeshtë qoftë, nga fillimi deri në fund.



### Këshilla konkrete për prindërit :

Mësoni të bashkëveproni me fëmijën dhe jo të ndërhyni e ta kritikoni atë, për mungesën e vëmendjes ose mungesën e interesit.

Stimuloni vëmendjen e tij mbi një veprimtari të preferuar duke e gërshetuar atë, me objektivin e thjeshtë të rritjes së përqëndrimit.

Zëvendësoni një veprimtari me të ngjashmen e saj, deri sa fëmija ta kryejë atë, nga fillimi deri në fund.

Shpërblejeni pozitivisht duke e nxitur autonominë dhe pavarësinë e tij, jo ta kritikoni si pjesë e mungesës së dëshirës në realizimin e një udhëzimi të thjeshtë.

Mos harroni, dekurajimi e mosbesimi në aftësitë e tij janë një pengesë në zhvillimin, jo vetëm të vëmendjes e përqëndrimit, por dhe karakteristikave të përgjithshme të personalitetit të tij.

Disiplina pozitive në thelb ndërton besimin se fëmija e realizon veprimtarinë e caktuar, pa ndikimin e të tjerëve.

Duke e shpërblyer edhe kur ai gabon, e ndihmoni fëmijën të mos dekurajohet, sepse ai po mëson se përpjekja vlerësohet.

